



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 208, Datë 27.06.2023

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S 64, DATË 08.04.2020 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “GEGA-G” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.06.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1753/2 prot., datë 22.06.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 64, datë 08.04.2020 “Mbi licencimin e shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s 64, datë 08.04.2020 “Mbi licencimin e shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me me vendimin nr. 64, datë 08.04.2020, ka vendosur:
  1. Të licencojë shoqërinë “GEGA-G” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
  2. Shoqëria në përfundim të procesit gjyqësor me objekt shfuqizimin e Aktit Administrativ “Njoftim vlerësimi për detyrimet” nr. 7647/7 Prot, datë 29.03.2016, të depozitohet në ERE vendimin përfundimtar të gjykatës.
  3. Mos plotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.
- Në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 2, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1753/1 prot., datë 20.06.2023, shoqëria ka depozituar në ERE Vendimin nr. 596, datë 07.12.2022, të Gjykatës Administrative të Apelit, ku është vendosur shfuqizimi i aktit administrativ “Njoftim vlerësimi për detyrimet nr. 7647/7 prot, datë 29.03.2016”. Me depozitimin e këtij vendimi, rezulton se ky kusht është plotësuar, ndaj si i tillë vlerësohet të shfuqizohet.
- Me shfuqizimin e pikës 2 të vendimit nr. 64/2020, nuk gjen më zbatim as pika 3 e këtij vendimi, e cila po ashtu vlerësohet të shfuqizohet.

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Pikat 2 dhe 3 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 64, datë 08.04.2020, shfuqizohen.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “GEGA-G” sh.p.k., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**